

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NË FUSHËN E BUJQËSISË

NDËRMJET

MINISTRISË SË BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL TË REPUBLIKËS
SË KOSOVËS

DHE

MINISTRISË SË BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural e Republikës së Kosovës dhe Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të Republikës së Shqipërisë, si në vijim: “Palët”, duke pasur parasysh marrëdhëniet ndër-qeveritare të zhvilluara në mënyrë të favorshme, me synim forcimin dhe shtrirjen e bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve dhe me qëllim zhvillimin e bashkëpunimit në fushën e bujqësisë kanë rënë dakord si në vijim:

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është angazhimi për mbështetjen dhe inkurajimin e përbashkët në marrjen e masave të duhura në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi për zhvillimin e mëtejshëm të bashkëpunimit reciprok të dobishëm në fushën e bujqësisë për të dyja palët.

Neni 2

Bashkëpunimi

1. Palët angazhohen si vijon :

- 1.1. Bashkëpunimi në përfrim të Politikave të Përbashkëta Bujqësore (CAP);
- 1.2. Shkëmbimin e informatave dhe përvojave në zhvillimin e sistemeve operacionale të zbatimit për përdorimin e fondeve të para anëtarësimit të BE-së (IPARD) dhe fondet për zhvillim rural të pas-anëtarësimit (EAFRD), si dhe për pagesat direkte (fondet e EAGF-së) dhe sistemit për identifikimin e parcelave të tokës (LPIS), si dhe Zhvillimin e Sistemit të Gjithmbarshëm të Kontrollit dhe Administratës së Integruar (IACS);
- 1.3. Bashkëpunim në fushën e blegtorisë, ruajtjes së resurseve gjenetike e kafshëve të fermës, bankës së gjeneve, shkëmbimin e përvojave në procedimin e njohjes së prodhimeve shtazore.
- 1.4. Shkëmbimin e përvojave në fushën e mbrojtjes së resurseve peshkore nga peshkimi ilegal i pa kontrolluar dhe i pa raportuar;
- 1.5. Shkëmbimin e përvojave në procesin e integritetit evropian/përafrimi i legjislacionit;
- 1.6. Shkëmbimin e informatave teknike dhe ekspertëve në fushën e koordinimit të asistencës së jashtme, menaxhimit të procesit të Integritetit Evropian, ndërtimin dhe fuqizimin e strukturave të angazhuara në këto procese;
- 1.7. Organizimin e përbashkët të eventeve, tryezave, simpoziumeve, seminareve, ekspozitave dhe panairëve të ndryshme në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural;

1.8. Bashkëpunimin dhe shkëmbimin e ekspertëve në lidhje me projekte mbi programet analitike në ndarjen e përvojave në fushën e statistikave bujqësore dhe regjistrave administrativ; shkëmbimit e të dhënave statistikore me qëllim krijimin e avancimit të sitemit të integruar bujqësor.

1.9. Shkëmbimi i përvojave rreth integritit të gruas fermere, si dhe mbi rëndësinë e pjesëmarrjes së saj në veprimtaritë e ndryshme bujqësore.

1.10. Bashkëpunim në sektorin e vreshtarisë dhe verës, tregtimin e fidaneve dhe materialit fidanor, nënshartesave dhe mbishartesave për kultivarët autentikë shqiptarë dhe me potencial prodhues.

1.11. Angazhimin për lehtësimin e shkëmbimeve tregtare duke hequr tarifat e kontrollit për import - eksportet, dhe angazhimin për mos rritjen e tarifave të tjera në të ardhmen.

1.12. Bashkëpunimin në zhvillimin e sektorit të agro-turizmit, shkëmbimin e përvojave në procesin e hartimit të legjislacionit dhe praktikave më të mira.

Neni 3 Zbatimi

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural e Republikës së Kosovës dhe Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural e Republikës së Shqipërisë janë përgjegjëse për zbatimin e kësaj marrëveshje.

Neni 4 Hyrja në fuqi

1. Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Palët.
2. Marrëveshja lidhet për një kohëzgjatje të pacaktuar.
3. Kjo marrëveshje mund të ndryshohet me miratimin reciprok me shkrim të Palëve në çdo kohë. Ndryshimet hyjnë në fuqi në përputhje me të njëjtën procedurë ligjore të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni.
3. Shpenzimet që lidhen me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje do të përballohen nga secila prej Palëve në varësi të disponueshmërisë së fondeve dhe në përputhje me legjislacionin kombëtar përkatës.
4. Mosmarrëveshjet lidhur me interpretimin dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhen përmes konsultimeve dhe negociatave ndërmjet Palëve.

Nënshkruar në ELBASAN..... më 26.11.2021 2021 në dy (2) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

**Për Ministrinë e Bujqësisë,
Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
së Republikës së Kosovës**

Faton Peci

**Për Ministrinë e Bujqësisë dhe
Zhvillimit Rural të Republikës
së Shqipërisë**

Frida Krifca